

MUZA COMPETITION 3 GUIDË APKIKIMI

FAZA 1

“MUZA COMPETITION” është një projekt i ndërmarrë nga Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon, i cili përfshin aktivizimin e të rinjve pasionantë dhe profesionistë, në rijetëzimin e elementeve etnografikë në fushën e fashion-dizajnit. Projekti i dedikohet të rinjve nga mosha 18-35 vjeç nga gjithë qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për t’u ofruar atyre një spektër më të gjerë mundësish profesionale që synojnë nxitjen e punësimit në ekonomitë krijuese, nxitjen e krijimit të bizneseve start-up në këtë fushë, apo zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

“MUZA COMPETITION” do të shërbejë si një qendër për ekonominë krijuese dhe një vend për mundësi të reja biznesi, shkëmbim dhe bashkëpunim, ide dhe zgjidhje, promovim dhe prezantim të risive më të fundit. Qëllimi ynë është të mbështesim potencialin e mendjeve të reja krijuese, për të nxitur interesin e tyre për trashëgiminë kulturore, duke paraqitur sinergjinë midis tendencave bashkëkohore të modës dhe elementeve tradicionale.

Tani është koha për të plotësuar dokumentat për të aplikuar dhe për të hyrë menjëherë në punë për të dërguar të gjitha skicat tuaja **deri më 25 Prill, ora 17:00**.

Kriteret për aplikim

1. Të rinj të moshës **18-35 vjeç** nga qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor;
2. Dorëzimi i skicave me veshjet të cilat duhet të përmbajnë si **tematikë kryesore elemente të etnografisë dhe trashëgimisë kulturore të qyteteve të ndryshme nga rajoni shqipfolës**, duke u bazuar në specifikat e detajuara si më poshtë:
 - Një portofol me një minimum prej **15 skicash** të veshjeve për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit (maksimumi 20) në formatin që ju dëshironi.
 - Elementët e etnografisë duhet të prezantojnë vetëm një rajon të caktuar, psh rajoni i Malësisë së Madhe etj.
 - Për cdo skicë, ju duhet të përshkruani shkurt materialet që mendoni të përdorni për realizimin e saj.
 - Dizajnet tuaja do të vlerësohen në disa kategori; përdorimi i elementëve të



Muza Competition



Unioni i Bashkive
Shqiptare në Rajon



BASHKIA
TIRANË



Balkan Cities Network

trashëgimisë kulturore, metodat e përdorura për prodhimin e dizajneve, kreativiteti dhe origjinaliteti, qëndrueshmëria, tregtueshmëria.

- Çdo veshje duhet të jetë veshje komplet.
- Këpucët dhe aksesorët nuk kërkohen të dizajnohen, por do t'ju duhen për të siguruar këpucë/aksesorë për koleksionin tuaj kur të arrini në fazat e mëtejshme të projektit.
- Krijimet duhet të jenë origjinale dhe që nuk janë publikuar apo përdorur më parë.
- Asnjë veshje nuk kërkohet të prodhohet në fazën e parë të aplikimit.
- Të gjithë të rinjtë që kanë aplikuar në edicionet e mëparshme të Muza Competition, mund të riaplikojnë në këtë edicion të tretë të Muzës, me kusht që aplikimi të mos jetë i njëjtë me aplikimin e mëparshëm.

Dokumentat që ju kërkohet të paraqisni:

1. Kartë identiteti të aplikantit;
2. CV
3. Formulari i aplikimit sipas formës së kërkuar në faqen e aplikimit;
4. Dorëzimi i **15 skicave** të veshjeve për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit (maksimumi 20).

Kur dorëzoni dokumentet e aplikimit, duhet të keni parasysh se:

1. Të gjitha dokumentet duhet të plotësohen në shqip ose anglisht.
2. Të gjitha dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen elektronikisht në adresën e emailit: muzacompetition@gmail.com, në formatin **pdf**.
3. Afati i fundit për aplikime është ditën e enjte, **25 prill 2024 në orën 17:00 (GMT + 1)**.
4. Çdo aplikim i marrë pas afatit të konkursit nuk do të pranohet.
5. Pas dorëzimit të aplikimit tuaj, do të merrni një konfirmim me email.
6. Ju lutemi, vini re se **NUK do të mund ta ndryshoni aplikimin** tuaj pasi ta dorëzoni.